



Kjo platformë është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj platforme është përgjegjësi e vetme e organizatës "EC Ma Ndryshe" dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të partnerit implementues Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Projekti i zbatuar nga EC Ma Ndryshe "Hartëzimi i Turizmit Rural në Jug të Kosovës" është pjesë e grantit financiar nga projekti "Trashëgimia Kulturore si Nxitëse e Dialogut ndërmjet Komuniteteve dhe Kohezioni Social" që financohet nga Shërbimi për Instrumentet e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian (FPI) dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Platforma KOSOVARURALTOURISM është zhvilluar nga EC Ma Ndryshe (EC) me qëllim të ofrimit të të dhënave praktike dhe orientuese për turistët vendor dhe të huaj. Rrjedhimisht ajo ka për qëllim dhe paraqet edhe një tjetër përpjekje të EC-it për promovim të turizmit kulturor dhe natyror të Kosovës, si një nga burimet potenciale kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Ideja për krijimin e kësaj platforme ka buruar edhe nga angazhimet dhe hulumtimet e deritashme të EC-it në fushën e turizmit të cilat kanë dëshmuar nevojën për promovim më të madh të pasurive kulturore dhe natyrore në vend. Për ilustrim, në një hulumtim në fushën e turizmit që EC ka realizuar në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Prizren në pyetjen se çka ju ka pëlqyer më së shumti në Prizren, pjesa më e madhe e turistëve të jashtëm dhe atyre nga rajonet e Kosovës të anketuar (27.4%) janë përgjigjur "Monumentet Kulturore dhe Fetare" dhe 17% e tyre "Vizitat në natyrë".


KOSOVARURALTOURISM është punuar me metodologji të paracaktuar. Për të siguruar ofrim të informatave të sakta dhe kredibile të dhënat janë mbledhur direkt nga terreni me ç'rast janë vizituar mbi 200 pika/lokacione. Për siguri edhe më të madhe, informatat e mbledhura janë verifikuar edhe nga institucionet përgjegjëse. Përpos saktësisë, aplikimi i kësaj metodologjie ka mundësuar edhe kontaktin e drejtpërdrejtë dhe ngritjen e kapaciteteve të ekipit të angazhuar. Platforma ofron informatat, si: lokacioni, kategoria e lokacionit, statusi i mbrojtjes, shenjëzimi, infrastruktura, shfrytëzimi, orientimi deri në lokacion nëpërmjet Google Map (Get Directions), gjatësia dhe gjerësia gjeografike për secilën pikë të hartëzuar. Të dhënat e lokacioneve të regjistruara janë të ndara në tre kategori kryesore: pasuri kulturore, pasuri natyrore dhe shërbime. Aktualisht, platforma përmban të dhëna për lokacione të të gjitha komuniteteve të Rajonit Jugor të Kosovës (Komuna e Prizrenit, Dragashit, Malishevës, Suharekës, Rahovecit dhe Mamushës) me planin që në të ardhmen të mbulojë të gjithë territorin e Kosovës.

Edhe pse qëllimi kryesor i platformës është informimi i vizitorëve vendor dhe atyre të huaj, zhvillimi i saj duhet parë edhe si kontribut në edukim dhe mbrojtje të pasurive si dhe nxitjen e angazhimit dhe diskursit institucional dhe publikut në përgjithësi mbi mundësitë, potencialet dhe nevojën e zhvillimit dhe promovimit tutje të turizmit në Kosovë.

Logoja e platformës KOSOVARURALTOURISM është unike për shumë arsye. Fillimisht paterna e saj paraqet motive autentike sepse është e inspiruar nga qilimat, veshjet dhe aksesorët tradicional të Kosovës. Përpos kësaj, inkorporon pasuritë natyrore të vendit, ajrin, tokën dhe ujin si dhe Hartën e Kosovës e simbolizuar në stil minimal dhe me shkronjën "K". Gjithashtu, ngjyra e logos paraqet natyrën dhe me elementet më sipër mund të përfundohet se si e tillë logoja i përgjigjet plotësisht qëllimit dhe përmbajtjes së platformës.



Emri: Restaurant "Ljollo" | Restaurant lokal me koncept etnogastronomik në të cilën gjindet dhe ujëvara e Lubinjës. | Lubinjë, Prizren



Emri: Veraria Stone Castle | Veprimtaria prodhuese ka filluar që nga viti 1953 | Rahovec



Restaurant tradicional i cili posedon dhe fermën private si dhe ofron specialitete të ndryshme si: mish edhi, viqi, pule etj.

Emri: Restaurant "Ura e Bublës" | Bubël, Malishevë



Emri: Restaurant "Gështenja" | Restaurant familjar përgjatë bjeshkëve të Dellocit. | Delloc, Suharekë



Emri: Ëmbëltore "Ekstra" | Ëmbëltore me traditë 70 vjeçare që ofron specialitete të ndryshme të zonës. | Dragash

Emri: Hotel "Arxhena" | Hotel dhe restaurant me gatime tradicionale të vendit. | Dragash



Emri: Festivali i Domates | Festival tradicional i promovimit të produkteve vendore i cili mbahet në Mamushë.



Emri: Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës | Prizren



Emri: Trungu i shpardhit (Quercus frainetto)|Monument natyror me karakter botanik | Bratotin, Rahovec



Zona është mjaft e përshtatshme për aktivitete të ndryshme si ngjitja, kajaku peshkimi, çiklizmi



Emri: Liqeni i Mirushës | 16 ujëvara me liqene | Malishevë



Monument natyror me karakter botanik. Gjithashtu pranë monumentit gjindet kroi i Dellocit.



Emri: Trungu i pishës (Pinus sp.) në Delloc



Emri: Liqeni i Breznës | Gjatësia e liqenit është rreth 250m, gjerësia 100m dhe thellësia maksimale rreth 10m.



Emri: Pikturimet shkëmbore te Guva e Mrrizit (Unike në Kosovë) në Muradem



Emri: Pikturimet shkëmbore te Guva e Mrrizit (Unike në Kosovë) në Muradem

Emri: Manastiri i Kryeengjuve | Jabllanicë, Prizren. Trashëgimi arkeologjike që daton nga periudha e



Emri: Kisha e Shën Nikollës | Hoçë e Madhe, Rahovec



Ura është ndërtuar mbi lumin Mirushë. Është karakteristike e urave me harqe të rajonit të shekujve XVIII dhe XIX të ndërtuar me material vendor.



Emri: Ura e Bublilit | Bubël, Malishevë



Emri: Xhamia e Gazi Mehmed Pashës| Shek.XVI | Leshan, Suharekë

Tyrbja e Sari Sallëkut e njohur edhe si tyrbja e Plavës ishte vepër kushtuar misionarit Sari Salltek.



Emri: Tyrbja e Sari Sallëkut | Plavë, Dragash



Emri: Kulla e Sahatit e Mahmud Pashës | Shek.XIX|Mamushë